



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	248/12
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	26.07.2012
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në nenin 40.2 "c" dhe "dh" si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në Vushtrri, në mbledhjen e mbajtur më **26.07.2012** mori këtë:

V E N D I M
PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE TË LIRA BUXHETORE NË INVESTITIME
KAPITALE

Neni 1

Me këtë vendim bëhet ridestnimi i mjeteve buxhetore nga projekti kapital për blegtori (me kodin e kategorisë 644470 dhe nënkodin e projektit 644470-1214757) në investimin e realizimit të një projekti tjetër kapital "Hartimi i Strategjisë Zhvillimore Komunale 2013-2018".

Neni 2

Në fondin në fjalë është shuma prej 25,000 euro, dhe nga kjo shumë ridestinohet shuma prej 10,000 euro për realizimin e projektit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, i cili projekt duhet të përfundojë brenda vitit 2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 247/12

Nr. i fq. / Br. st. - 7 -

Data: / Datum 26. 07. 2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të neneve 11,12.1 dhe 40.2" c" të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 40.2 "dh" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Shoqatës "Handikos", dega në Vushtrri, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26.07.2012**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDIHMË FINANCIARE PËR SHOQATËN "HANDIKOS" DEGA NË
VUSHTRRI

Neni 1

Shoqatës "HANDIKOS" dega në Vushtrri i ndahen mjete financiare në shumë prej 2.160 € (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro) nga Fondi për Transfere dhe Subvencione i buxhetit të komunës për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Neni 2

Mjetet në shumën e cekur si në nenin paraprak të këtij vendimi ndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe jo Publike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesi i këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 246/12

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data / Datum 26. 07. 2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 30.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 67.1 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të iniciativës së bashkathetari tonë Islam Islami (nga fshati Ashlan, i cili jeton në Suedi) dhe Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, Bajram Mulaku, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më: **26.07.2012** mori këtë:

V E N D I M
PËR BINJAKËZIM NË MES TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË DHE KOMUNËS SË VÄXJÖ-s të SUEDISË

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë vendos marrëdhënie të binjakëzimit me Komunën e Växjö-s me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe realizimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të dy komunave në fjalë në fusha të ndryshme.

Neni 2

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi për binjakëzim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Växjö-s (në shqiptim Vekshjo) të Suedisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa
Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 245/12

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data / Datum 26. 07. 2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **26.07.2012**, pas shqyrtimit të Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës (KAB-i) së Vushtrrisë për periudhën 2013-2015, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KAB-i) së Vushtrrisë për periudhën 2013-2015.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 27.07.2012 dhe zgjatë deri më 03.09.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-korniza në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa
Habib Mustafa



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 254 / 12

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data: / Datum 26. 07. 2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **26.07.2012**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2013 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2013 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 27.07.2012 dhe zgjatë deri më 03.09.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa

